

Platforma

2020-2024

Platforma e kandidatit për drejtues të njësisë kryesore,
Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë,
Prof.as.dr.Sonela Stillo.

24

“Të vazhdojmë të punojmë së bashku, për të konsoliduar sukseset dhe për të gjetur alternativa të reja zhvillimi, që na çojnë drejt përmbushjes së misionit tonë”.

Prof.as.dr.Sonela Stillo

Fjalimi i kandidatit Prof.as.dr.Sonela Stillo



Të dashur kolegë!

Së pari, dua të shpreh falenderimin tim për secilin prej jush, për angazhimin, përpjekjet, përkushtimin dhe kontributin tuaj në suksesin e Fakultetit, me të cilin ne kemi lidhur karrierën tonë profesionale, duke u bërë edhe pjesë e një familjeje të përbashkët.

Fakulteti i Ekonomisë është një shtyllë e rëndësishme e institucionit tonë, është një lider i padiskutueshëm në Rajon, është shpresa dhe dëshira e maturantëve cilësorë që e dëshirojnë suksesin.

Fakulteti i Ekonomisë, është orientuar drejt sfidave dhe suksesit, por që sigurisht ka mjaft për të bërë. Ne kemi treguar se kur përballemi me vështirësi, dimë t'i përballojmë së bashku dhe patjetër që do të gjejmë mes nesh ide dhe alternativa sfiduese.

Fokusi ynë është i qartë, të përgatisim specialistë të ekonomisë dhe biznesit, të kontribuojmë në ofrimin e mundësive të punësimit, si edhe në gjetjen e mekanizmave që e çojnë shoqërinë drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Jam ndjerë e privilegjuar që ju për shumë vitë më keni besuar drejtimin e një prej Departamentëve, atij të Menaxhimit, por jam ndjerë e motivuar gjith-

monë në punën time nga përkushtimi, serioziteti, mirëkuptimi dhe përgjegjshmëria e çdo anëtari të stafit. Kjo eksperiencë, ka qenë një shkollë për mua. Kemi shijuar së bashku plot suksese, kemi përballuar mjaft sfida si kjo e Covid 19, kemi mbështetur njëri-tjetrin në karrierën tonë dhe kemi diskutuar mes nesh defektet dhe mundësitë e pashfrytëzuara.

Jam e bindur të dashur kolegë, se ne të gjithë dëshirojmë më të mirën për Fakultetin tonë, i cili duhet të jetë lubrifikanti i ekonomisë dhe shoqërisë sonë. Bashkëpunimi me secilin prej jush në punën time, besimi që keni treguar ndaj meje dhe dëshira për të dhënë më të mirën nga vetja, për atë që unë di dhe mund të bëj, më nxisin të kërkoj besimin tuaj për të drejtuar Fakultetin tonë së bashku, drejt përmbushjes së misionit.

Vendimi im për këtë kandidim, ka ardhur pas një procesi të gjatë reflektimi, analizash, takimesh. Të gjitha me çonin në një pikë, dëshirë për të kontribuar në fuqizimin e këtij fakulteti që më formoi, më bëri të ndjehesha krenare, më jep kënaqësi dhe që është frymëmarrje për institucionin, Rajonin dhe më gjerë.

Të nderuar kolegë, bashkë kemi kaluar sfida të shumta, që na kanë bërë më të fortë. Ju dhe studentët jeni burimi më i çmuar. Forcimi i zërit tuaj, komunikimi dhe bashkëpunimi mes nesh, respektimi i autonomisë, krijimi i kushteve për zhvillim profesional, do të jenë shtyllat e punës sime, në funksion të së mirës sonë të përbashkët.

Të dashur studentë të Fakultetit të Ekonomisë!
Së pari, uroj që ju dhe familjet tuaja, të jeni mirë me shëndet dhe të kaloni me sa më pak vështirësi situatën e pazakontë me të cilën u përballëm dhe vazhdojmë t'a sfidojmë çdo ditë!

Ju na keni besuar të ardhmen tuaj, ndaj unë dhe kolegët e mi kemi përgjegjësi dhe detyra që duhet t'i përmbushim.

Jam e ndërgjegjshme, që rruga ku unë do të eci bashkë me ju, nuk do të jetë e lehtë. Na pret një punë e madhe, që kërkon edhe një angazhim serioz, por ne së bashku përballuam një situatë të pazakontë, dhe ja dolëm që me përkushtim, seriozitet dhe me ndjenjë të lartë përgjegjshmërie, të finalizonim një proces mësimor të pazakontë. Siguria juaj, ishte dhe vazhdon të jetë prioritare, por etja për dije do të jetë motivi, i cili do të na shtyje drejt përqafimit të sfidave të reja.

Kreativiteti, energjia, shpresa juaj, më nxisin

për të ndërmarrë këtë sipërmarrje, frytet e së cilës do t'i shijojmë pas një pune të gjatë dhe të vështirë, por që sigurisht do të na japë shumë kënaqësi. Ju jeni aseti më me vlerë i shoqërisë, ndaj le të përpiqemi së bashku për të ndërtuar ura lidhëse të konsoliduara, për t'i shërbyer me dijet tona, vetes, familjeve dhe shoqërisë.

Le t'i japim së bashku, frymëmarrje institucionit dhe qytetit tonë, duke dhënë më të mirën nga vetja dhe duke kërkuar hapësira të reja kërkimi, bashkëpunimi, kualifikimi, të cilat do të na çojnë drejt suksesit.

Jam e bindur që së bashku do të gjejmë alternativa zhvillimi, duke parë drejt horizontit. Vizioni im për një mësimdhënie bashkëkohore, dhe jo vetëm, kërkon mendimet dhe sugjerimet tuaja, ndaj le të jetë ky mesazh, vetëm fillimi i tryezave tona, ku do të rrahim mendime, do të gjejmë zgjidhje dhe do të mundësojmë përmbushjen e misionit tonë.

Ju uroj suksese në vazhdim, por së pari kujdesuni për shëndetin tuaj dhe të familjarëve tuaj!

Me respekt dhe vlerësim
Sonela Stillo

Fokusi 4- vjeçar për stafin e Fakultetit të Ekonomisë

Stafi i Fakultetit të Ekonomisë, është ndër më të kualifikuarit në nivel institucional. Brenda stafit të këtij Fakulteti ka harmoni brezash, që reflektohet më pas edhe në procesin mësimor. Filozofia e punës së dekanit do të jetë respekti mes nesh, bashkëpunimi me të gjitha organet kolegjiale dhe respektimi i ligjit. Puna ime do të fokusohet në këto drejtime:

1 - Vlerësimi i punës së çdo pedagogu, si në aspektin material edhe në atë moral.

2 - Meritokraci në ndarjen e çdo shpërblimi, apo pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme.

3 - Veprimtaria kërkimore-shkencore e stafit akademik, përfshirë konferencat dhe botimet shkencore, shoqërohet sigurisht me kosto të konsiderueshme, ndaj ngritja e zërit me force për mbështetje financiare do të jetë një çështje prioritare.

4 - Një e metë e stafit tonë është angazhimi minimalist në projektë, ndaj nëpërmjet edhe bashkëpunimit më të frytshëm me zyrën e projekteve, të mundësojmë mbështetje, transparencë dhe konsulencë për hartimin e projekteve si edhe menaxhimin e tyre. Unë shpreh idenë e ngritjes së një qendre të tillë edhe në nivel Fakulteti, për të qenë me afër terrenit të implementimit të tyre dhe njohjes së specifikave të fushës.

5 - Bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës dhe të gjithë homologëve tanë si brenda vendit, në Rajon (Greqi, Bullgari, Rumani) dhe më gjerë, për të shkëmbyer ide dhe për të stimuluar metoda bashkëkohore në mësimdhënie dhe në organizimin e konferencave dhe tryezave të përbashkëta.

6 - Bashkëpunim me aktorë të jashtëm për përsosje të kurrikulave, me elementë bashkëkohore, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të formimit të studentëve sipas kërkesave që kërkon tregu i punës. Vlerësoj si

mjaft të frytshëm bashkëpunimin me Bashkinë, për të angazhuar pedagogë dhe studentë në projekte, apo studime të përbashkëta, që kanë impakt konkret.

7 - Cilesia e jetës së punës kushtëzohet edhe nga mjedisi ku stafi punon dhe harxhon një pjesë të mirë të ditës, ndaj fokus i punës së dekanit do të jetë edhe krijimi i mundësive për mjedise bashkëkohore, duke i mëshuar ndërtimit të një godine të re, ose rikonstruktimit total të godinës së Fakultetit, për t'u konceptuar si një mjedis universitar.

8 - Krijimi i mobiliteteve akademike për stafin e Fakultetit të Ekonomisë, sigurisht që do të reflektohet edhe në procesin mësimor dhe atë shkencor, ndaj në fokus do të jetë ofrimi i mundësive, transparencë, drejtësi për të gjithë.

9 - Forcimin e harmonisë brenda Fakultetit edhe përmes gjallërimit të jetës sociale.

Kërkimi shkencor dhe ndërkombëtarizimi

Kërkimi shkencor do të jetë në focus të punës së Fakultetit. Të gjithë janë shumë të ndjeshëm ndaj çështjeve ekonomike, ndaj edhe puna jonë është bërja e kërkimeve dhe gjetja e mundësive të bashkëpunimit me faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, për të rritur besimin e opinionit të biznesit dhe atij qytetar ndaj Fakultetit tonë si tempulli i dijes, i ofrimit të mundësive sipërmarrëse dhe një dritare suksesi.

Në këtë kuadër mendoj si mundësi:

- 1 - Fuqizimin e bashkëpunimit ndërdepartamental, brenda fakultetit, por edhe ndërmjet fakulteteve të tjera të Universitetit, i cili do të rrisë edhe bashkëpunimin mes disiplinave. Shkëmbimi i eksperiencave me homologët tanë brenda dhe jashtë vendit do të jetë një mundësi e mirë zhvillimi.
- 2 - Shndërimin e Fakultetit të Ekonomisë në një faktor kyç të zhvillimit ekonomik. Fakulteti, me burimet e tij njerëzore, mund të shërbejë si një qendër biznesi, përmes stimulimit të ideve (start up), hartimit të planeve të biznesit, menaxhimit të projekteve, etj, Stafi i Fakultetit i ka të gjitha kualifikimet e duhura për të kryer trainime për studentët dhe palët e interesuara, duke sjellë afër me njëri-tjetrin auditorin dhe mjedisin real të punës.
- 3 - Forcimin e bashkëpunimeve dhe ndërtimin e urave lidhëse mes Fakultetit dhe Sektorit Privat. Ky sektor duhet t'a shohë Fakultetin si një të mirë, që do t'i ofrojë specialistët e ekonomisë dhe biznesit, si edhe një partner strategjik me të cilin të ndajë sukseset dhe dështimet.
- 4 - Eshtë pozitive që tashmë Fakulteti ynë ka revistën e tij, "Studime ekonomike". Rritjen e cilësisë së revistës do të jetë prioritet, me pretendimin për t'a indeksuar ndër revistat prestigjioze, me qëllim bërjen me dije të kapaciteteve të Fakultetit dhe për të shërbyer si një mënyrë e mirë njohjeje, komunikimi, diskutimi dhe kërkimi me kolegët tanë në Shqipëri dhe jo vetëm. Me revistën tonë ne do të jemi të hapur ndaj cdo specialisti të ekonomisë në institucione të ndryshme, për të ndarë mendime dhe ofrimin e rekomandimeve të suksesshme.
- 5 - Shpërblimi financiar i pedagogëve dhe studentëve, të cilët nëpërmjet punës se tyre kërkimore, kanë krijuar një vlerë të shtuar për shoqërinë.

Në kuadër të ndërkombëtarizimit vizioni im përqendrohet në këto drejtime:

1 - Mundësi edhe përmes mekanizmave dhe mbështetjes institucionale, të bashkëpunimeve me universitete europiane, për shkëmbimin e eksperiencave dhe ofrimin e programeve të përbashkëta në fushën e ekonomisë.

2 - Rritja e mobiliteteve në kuadër të programit Erasmus.

3 - Përpjekje maksimale për të aplikuar dhe fituar projekte ndërkombëtare.

4 - Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare, përfshirë këtu Konferenca, Workshope, Tryeza të rrumbullaketa, etj

Studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë

Studentët janë aseti më me vlerë i Fakultetit tonë. Është detyra dhe përgjegjësia jonë t'i përgjigjemi me cilësi dhe standarte, si edhe të justifikojmë besimin e tyre duke na zgjedhur ne, si krijues të së ardhmes së tyre. Fokusi primar sigurisht do të vazhdojë të jetë ofrimi i standarteve të larta në mësimdhënie dhe kërkim, por pa neglizhuar përfshirjen e tyre në aktivitete dhe stuktura drejtimi. Është detyrimi jonë që të bëjmë më të mirën për ta, si në aspektin profesional, edhe në jetën studentore.

Gjatë gjithë punës sime në këtë mandat 4-vjeçar, do të fokusohem tek studentët dhe interesat e tyre. Disa nga drejtimet ku do të punohet fort janë:

Rishikimi i kurrikulave mësimore, me qëllim ofrimin tek studentet e një literature sa më bashkëkohore, korrekte dhe të kuptueshme.

Situata e pazakontë me të cilën u përballëm, kërkoi edhe implementimin e metodave të reja në mësimdhënie. Platformat online shihen sot si një metodë bashkëkohore komunikimi mes studentëve dhe pedagogëve, ndaj fokusi i punës sime do të jetë funksionimi sa më efektiv dhe eficient i sistemit informatik edhe kur t'i kthehemi normalitetit dhe auditoreve tona. Përmes këtyre platformave, komunikimi mes studentëve dhe pedagogëve do të shtrihet në çdo element mësimor, si në ofrimin online të materialeve mësimore, zhvillimi i testeve online, vlerësimi online, etj.

Një problem që kërkon zgjidhje sa me të shpejtë, është mënyra e zhvillimit të praktikave mësimore dhe atyre profesionale. Në këtë kuadër, puna do të fokusohet në rishikimin e marrëveshjeve egzistuese dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të reja mes institucioneve publike dhe private, dhe kjo në nivel Qarku.

Mbështetje maksimale ndaj forumeve studentore, duke stimuluar pjesëmarrjen e tyre në paraqitjen e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve. Do të angazhohem maksimalisht në ndryshimin e një mentaliteti të ndrydhur, për të gjeneruar ide nga studentët dhe për të shfrytëzuar energjinë e tyre në të mirë të institucionit, dhe Fakultetit në veçanti. Në këtë aspekt do të mbështes përfshirjen e studentëve në grupimin studentor “Laboratori i dijes”, i cili funksionon në nivel institucional, inicuar nga studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe humane, për të stimuluar dashurinë për dijen.

Mbështetje maksimale e studentëve në organizimin e aktiviteteve sociale dhe sportive.

Në kuadër të programit Erasmus, do të mbështes fort studentët të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e përfitimit të këtyre mobiliteteve. Shkëmbime të tilla, mundësojnë progresin dhe formimin e mendësive bashkëkohore.

Mbështetje maksimale për të forcuar bashkëpunimin dhe komunikimin mes studentëve dhe stafit akademik. Fryt i bashkëpunimit pritet të jetë edhe pjesëmarrja e përbashkët në konferenca, apo projekte kërkimore.

Në mungesë të një njësie projektesh brenda Fakultetit, do të këmbëngul në funksionimin e qendrës në nivel institucional në të mirë të studentëve, duke ju siguruar infrastrukturën dhe stafin e specializuar, për t'ju bërë transparente mundesitë dhe për t'i ndihmuar për plotësimin e të gjithë dokumentacioneve të nevojshme. Në kuadër të mobiliteteve ndërkombëtare do të inkurajoj zhvillimin e intershipeve, në shtete perëndimore dhe jo vetëm.

Do të këmbëngul që Qendra e Karrierës të fuqizojë punën për të përmbushur misionin e saj, duke shërbyer si ndërmjetës mes tregut të punës dhe tregut akademik. Bashkërisht me Qendrën do të përpiqemi të krijojmë

një rrjet bashkëpunëtorësh në tregun e punës, duke krijuar mundësi punësimi. Vec kësaj, do të punojmë fort me Qendren e Karrierës, për t'ju krijuar lehtësi studentëve, për të qënë pjesë e trajnimeve, shkollave verore/dimërore, workshopeve, apo kampionateve të debatit. Të gjitha keto aktivitete do të formojnë studentë me polivalence njohurish dhe aftësish, të aftë për t'u përballur denjësisht me tregun e punës.

Krijimin e forumit studentor "Ambasadorët Erasmus FEUK", një grup i cili propozohet nga Universtëti i Tiranës, i cili do të synojë promovimin, ndarjen e eksperiencave dhe nxitjen e mundësive të bashkëpunimit për të gjithë studentët e Fakultetit Ekonomik, që kanë qënë pjesë e programit Erasmus. Ky forum do të shërbejë edhe si network për ndërmarrjen e nismave studentore me propozim të studentëve.

Organizimin e konferencave studentore, ku studentët të shpalosin fillimet e punës së tyre kërkimore, nëpërmjet prezantimit të detyrave të kursit, apo temave të diplomave.

Së bashku, do të trokasim në çdo derë dhe do të tregojmë se ne jemi elita e një shoqërie dhe do të kërkojmë në këmbim të punës sonë të palodhur, respekt, vlerësim, dinjitet dhe meritokraci.

“Ajo ç’ka ne do të bëjmë sot, do të jetë ajo që do të jetojnë brezat nesër”

PROF.AS.DR.SONELA STILLO

20

FALEMINDERIT!

Kandidat për drejtimin e njësisë kryesore, Fakulteti i
Ekonomisë, Universiteti "Fan S.Noli", Korçë.

24

Mirëpres çdo sugjerim dhe mendim tuajin, për përmirësimin e ideve të mia.